



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.12, datë 13.04.2026

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT
PROJEKTRREGULLORE “PËR REGJISTRIMIN DHE ADMINISTRIMIN E EMRAVE
TË DOMAIN-EVE “.AL, .GOV.AL, .MIL.AL, .EDU.AL, .COM.AL, .ORG.AL DHE
.NET.AL**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Diana Dervishi	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës _____.2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” miratuar me vendimin nr.11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP me propozim të Drejtorisë së Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Projektregullore “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al

BAZË LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 133 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti për miratim për këshillim publik të projektregullores “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Projektvendimi i arsyetuar,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, hyri në fuqi më datë 20.12.2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji i ri nr. 54/2024 ka përafruar pjesërisht në legjislacionin kombëtar, Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” (EECC).
2. Dokumenti për këshillim publik: Projektregullore “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al, është hartuar në përputhje me përcaktimet e pikës 2, germa dh të nenit 12, nenit 133 të ligjit nr. 54/2024 sipas të cilit: *“AKEP-i përcakton me rregullore rregulla të veçanta të detajuara për metodologjinë, pagesat, procedurën dhe mënyrën e administrimit të emrave të domain-eve dhe të nëndomaineve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe mban një regjistër për “domain-namet” e regjistruara dhe entitetet regjistruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 17.04.2025 “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë qendrushmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për domain- name-t “.al”.*
3. Projektregullorja parashikon një rregullim të plotë të kësaj fushe, duke përfshirë dispozitat e përgjithshme, kriteret dhe kufizimet për emrat e domain-eve, organizimin dhe funksionimin e regjistrit, rregullimin e aktivitetit të regjistruesve, të drejtat dhe detyrimet e zotëruesve, procedurat për regjistrimin dhe administrimin e domain-eve, mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

4. Në këtë kontekst, projektakti garanton një administrim më të sigurt, transparent dhe efikas të domain-eve, nëpërmjet vendosjes së një kuadri rregullator të qartë dhe të standardizuar, duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta, rritjen e sigurisë dhe integritetit të hapësirës .al, si dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikën ndërkombëtare.
5. Bazuar në nenet 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 dhe rregullores “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 21, datë 07.12.2021, dokumenti i miratuar nëpërmjet këtij vendimi, do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë për këshillim publik projektregulloren “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e këshillimit publik do të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit sipas pikës 3 të këtij vendimi.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për këshillim publik: Projektregullore “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve “.al, .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Armer Juka	Bleron Dokle	Edlira Dvorani	Diana Dervishi